



Crna Gora / Mali i Zi
Opština Ulcinj
Komuna e Ulqinit
Sekretarijati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji
e-mail: zecarije.sulejmanovic@ul-gov.me
agroul@ul-gov.me

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi

Br./Nr. 17-314/25 - 133/1

Ulcinj/Ulqin, 22.04.2024. god. vit

Sekretariati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji në bazë të nenit 42 të Vendimi për Masat Stimuluese për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ("Fletorja zyrtare MZ-dispozitat komunale numër 17/2023, të datës 13.04.2023), në pajtushmëri me Buxhetin e Komunës së Ulqinit dhe me Planin e shfrytëzimit të mjeteve për mbështetje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2024 numër 01-041/23-2020/31, shpall:

THIRRJEN PUBLIKE

Për ndarjen e mjeteve mbështetese për zhvillimin e bletarisë për vitin 2024

- **Bletarët e rinj; blerja e veglave dhe pajisjeve për bletari -**

SUBJEKTI I THIRRJES

Në kuadër të masave mbështetëse për zhvillimin e bletarisë për vitin 2024, përfituesi realizon të drejtën e mjeteve mbështetëse për investime që kanë të bëjnë me bletarët e rinj; blerjen e veglave dhe pajisjeve për bletari .

PËRKUFIZIMI I PËRDORËSVE TË MBËSHTETJEVE

Të drejtën e mbështetjes sipas kësaj thirrje publike kanë personat fizik dhe juridik. Personat fizik duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e amvisërive bujqësore dhe në Regjistrin e prodhuesve të mjalit ose/dhe Regjistrin e prodhuesve të produkteve të bletëve, që mbanë Drejtoria për Siguri Ushqimore, Çështje Veterinare dhe Fitosanitare. Nëse dorëzuesit e kërkesës janë persona juridik veprimtaria e tyre primare duhet të jetë nga sektori A: bujqësia, pylltaria, peshkimi, në pajtushmëri me Ligjin për klasifikim të veprimtarive („FI. Zyrtare e MZ“, numër 152/22). Dorëzuesi i kërkesës duhet të ketë vendbanimin, gjegjësisht selinë në territorin e komunës së Ulqinit dhe veprimtarinë bujqësore ta ushtrojë në komunën e Ulqinit.

INVESTIMET E PRANUESHME

Investimet që mbështeten me këtë thirrje janë:

- Bletarët e rinj – fillestarët (blerja e koshereve)
- Blerja e veglave dhe pajisjeve për bletari

SHUMA E MBËSHTETJES

Për mjetet mbështetëse sipas Planit të shfrytëzimit, gjithsej janë përcaktuar **10,000.00€** për vitin 2024.

Investimi maksimal i pranueshëm me mbështetje buxhetore prej 50% të vlerës së investimit të pranueshëm është **500.00 €**

Përveç shumës së mbështetjes prej 50%, një shtesë prej 10%, pra gjithsej **60%** mbështetje nga shuma e investimit të pranueshëm mund të marrin gratë dhe të rinjtë si aplikantë që kryejnë veprimtari bujqësore si pronare të amvisërive bujqësore.

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PRANUESHMËRISË

Të drejtën për mbështetje shfrytëzuesi mund ta realizojë nëse:

- i plotëson të gjitha kushtet sipas Vendimit për masat stimuluese për zhvillim bujqësor dhe rural;
- nuk ka obligime tatimore të pashlyera ndaj administratës lokale;
- për të njëjtin investim nuk ka marr mjete nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave.

Kushtet e përgjithshme për bletarët e rinj janë:

- Që aplikanti/ja të jetë 18-35 vjeç;
- që aplikanti/ja ose një anëtar i/e familjes së tij të mos merret me bletari.

Me këto masa nuk mbështetet:

- blerja e paisjeve dhe mekanizimit të përdorur,
- shpenzimet tatimore, doganore, importi, taksat administrative dhe të ngjashme,
- shpenzimet e mjeteve qarkulluese dhe shpenzimet operative,
- shpenzimet e punës së vet (pagat, kontributet).

KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË

Bletarët duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e amvisërisë bujqësore. Bletarët duhet të kenë një numër të mbështetur shoqërisht bletësh në pronësi në momentin e publikimit të Thirjes publike për të ushtruar të drejtën e mbështetjes.

Bletarët e rinj janë personat nën moshën 35 vjeç.

Nëse objekt i investimit është formimi i bletarisë, numri i shoqërive të bletëve në fund të investimit nuk mund të jetë më i vogël se 5, dhe nëse objekt i investimit është zgjerimi i bletëve ekzistuese, numri i shoqërive të bletëve duhet të jetë rritur me të paktën 3 koshere.

Nëse objekti i investimit është blerja e shoqërive të bletëve për ngritjen e bletëve për **fillestarët**, mbështetet blerja e deri në **3 koshere**.

Nëse objekti i investimit është blerja e pajisjeve, numri i shoqërive të bletëve nuk duhet të jetë më i vogël se 10.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kërkesa për pranimin e mbështetjes/investimit;
- Vendimi i regjistrimit të amvisërisë bujqësore që e lëshon Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave (numri ID i amvisërisë);
- Vendimi nga Regjistri i prodhuesve të mjaltit;
- Për persona juridik ekstrati nga CRPS, (regjistri qendror për subjete ekonomike) ;
- Fotokopia e letërnjoftimët të dorëzuesit të kërkesës;
- Vërtetimi se aplikanti nuk ka obligime tatimore ndaj organeve të admin. lokale;
- Dëshmi se blerja është paguar për:
 - faturë fiskale e shoqëruar me fletëdorëzimin me emrin e blerësit;
 - në rastin e pagesës përmes xhiro llogarisë (pagesat llogaritare) , pagesa e vërtetuar (fletëpagesa) për transferimin e mjeteve te furnizuesi dhe fatura e vërtetuar;

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR BLETARËT E RINJ FILLESTAR

- Kërkesa për ushtrimin e së drejtës për mbështetje
- Fotokopia e letërnjoftimët të dorëzuesit të kërkesës;
- Deklarata për bashkësin familjare;
- Marrëveshje e certifikuar për shitblerje;
- Fletëpagesë e vërtetuar për transferimin e mjeteve

Pas realizimit të investimit, gjegjësisht pranimit të Vendimit për miratimin e mbështetjes, aplikanti është i obliguar që bletarinë ta regjistrojë në Regjistrin e prodhuesve të mjaltit dhe produkteve të bletëve pranë Drejtorisë për Siguri ushqimore, çështje veterinare dhe fitosanitare.

SI TË DËRGONI KËRKESËN

Formulari i Kërkesës për mbështetje aktiviteteve për zhvillimin e bletarisë (Bletarët e rinj; blerja e veglave dhe pajisjeve për bletari) për vitin 2024 mund ta merrni në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji si dhe në Byronë e qytetarëve të Komunës së Ulqinit. Formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentacionin përcjellës dërgohet në Byronë e qytetarëve të Komunës së Ulqinit apo me postë në adresën:

Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji

Kërkes sipas Thirrjes publike për ndarjen e mjeteve mbështetëse për aktivitetet e zhvillimit të bletarisë për vitin 2024

Afati i dërgimit të kërkesës është **31 maj 2024**, gjegjësisht deri në ndarjen e mjeteve të dedikuara për realizimin e këtij programi.

Nëse mjetet shpenzohen para datës 31 maj 2024, Thirrja publike do të mbyllet për çka do të informohen prodhuesit.

PROCEDURA E REALIZIMIT

Sekretariati do të vizitojë prodhuesit që kanë dorëzuar dokumentacionin, para se të lejohet mbështetja financiare, për të bërë verifikimin në vend të të dhënave dhe kushteve të parapara me Vendimin për masat stimuluese për bujqësi dhe zhvillim rural dhe me këtë Thirrje, dhe për këte bënë procesverbalin (Foto procesverbalin) me vlerësim dhe mendim për plotësimin e kushteve për përfitimin e mjeteve mbështetëse financiare.

Nëse shfrytëzuesi nuk lejon ose ndalon punën e Sekretariatit në terren, ose në ndonjë mënyrë tjetër ndikon në punën e tij, kërkesa e shfrytëzuesit do të refuzohet.

Në bazë të dokumentacionit të dërguar dhe shqyrtimit në vend Sekretariati konstaton a janë të plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës për mjete dhe me aktvendim lejon pagesën e mjeteve mbështetëse financiare.

Shfrytëzuesit duhet t'i shpenzojnë mjetet mbështetëse për atë që janë dedikuar dhe nuk mund t'i tjetërsojnë ata, ose t'i japin dikujt tjetër për përdorim investimin sipas kësaj kërkesë, në periudhën 5 vjeçare prej ditës së përfitimit.

Kontrolin e shpenzimit të mjeteve të lejuara për mbështetje në kontinuitet do ta ushtrojë organi kompetent për punët e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Shfrytëzuesit që përdorin mbështetjen për qëllime jo të synuara, me vendim të organit kompetent, humbasin të drejtën e mbështetjes për çka Sekretariati nxjerr vendim të posaçëm me të cilin urdhërohet përfituesi të kthejë mjetet.

Në këtë rast, përfituesi obligohet të kthejë mjetet e përfituara plotësisht në afatin prej 30 ditëve prej marrjes së vendimit.

Personat që kanë dhanë të dhëna jo të sakta në kërkesën e tyre, e të cilat i konstaton organi kompetent, nuk kanë të drejtë në masat mbështetëse.

Përfituesit duhet të ruajnë dokumentacionin në bazë të së cilët kanë fituar të drejtën për masën mbështetëse, më së paku pesë vjetë prej ditës së marrjes së mjeteve mbështetëse. Aplikanti kërkesa e të cilit refuzohet do të lajmërohet për shkaqet e refuzimit. Normat ndëshkuese janë të normuara në nenin 49 dhe 50 të Vendimit për masat mbështetëse për zhvillim bujqësor dhe rural.

VËREJTJE:

Kërkesat e arritura pas afatit Sekretariati nuk do t'i shqyrtojë.

Sekretariati do të pranojë si të vlefshme faturat e vitit 2024 deri në datën e skadimit të afatit të thirrjes publike (31.05.2024).

Informatat në lidhje me Thirrjen publike mund të merren në e-mail agroul@ul-gov.me ose personalisht në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji.